

**AKTI I THEMELIMIT I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“Kuka AL” shpk

Sot, ne Tirane, me daten 04.02.2025, z. Arion Kuka, mblidhet, diskuton dhe vendos sa vijon:

NENI 1

Krijohet shoqeria “Kuka AL” shpk.

Nga ortakut themelues: **Arion Kuka**.

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia zyrtare e shoqerise do te jete ne: Rruga Bulevardi “Gjergj Fishta”, Tirane, Hyrja 2, nr pasuri 6/262-N4 dhe 6/262-N5, zona kadastrale 8220.

NENI 3

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 2,000,000 (dy milion) leke i ndare ne 1 kuote.

NENI 4

Kuotat e kapitalit te Shoqerise zoterohen nga ortakët si me poshte:

Z. Arion Kuka, zoteron 1 (nje) kuote me vlere 2,000,000 leke ose 100% te kapitalit.

Asambleja e pergjithshme mund te rrise pa kufi kapitalin e shoqerise. Rritja e kapitalit mund te behet nepermjet financimoit te ortakëve ose nepermjet perfshirjes ne kapital te fitimeve dhe rezervave te shoqerise.

Kuotat e kapitalit mund t’u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te asamblese se pergjithshme bazuar ne dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parashikimeve te Statusit te Shoqerise.

NENI 5

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.

NENI 6

Shoqeria zhvillon aktivitetin tregtar ne perputhje te plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi, bazuar ne Ligjin nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe bazuar ne kete Akt Themelimi dhe Statutin e saj.

NENI 7

Shoqeria hap llogari bankare ne monedhe shqiptare dhe ne cdo valute tjeter ne banka vendase ose te huaja, private apo shteterore me qellim ushtrimin e aktivitetit te saj.

NENI 8

Ortaket kane te drejte te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire fondet dhe kontributet e pjeseve te kapitalit themelor. Transferimet duhet te jene te vertetuara me Akt Notal dhe duhet te merret paraprakisht vendimi me shkrim i Asamblese se Ortakeve. Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo te behen te ditura.

NENI 9

Aktiviteti i shoqerise do te jete:

Tregtim me shumice dhe me pakice import eksport te artikujve te ndryshem industrial, artikuj elektroshtepiake etj. Import eksport te aksesoreve te tyre, transport për veten dhe të tretë, si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar te lejuar me ligj.

NENI 10

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime te tjera te cilat jane me interes per shoqerine.

NENI 11

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptare ose te huaj, ose te bashkohet me nje shoqeri tregtare tjeter si brenda dhe jashte vendit.

NENI 12

Organi me i larte drejtues i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e cila eshte pergjegjese per vendimet e shoqerise duke ushtruar kompetencat bazuar ne ligjin “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Ortaket mund ti delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve te caktuar prej tyre ose nje person fizik jashte ortakerise se shoqerise, bazuar mbi nje prokure.

NENI 13

Duke filluar nga data e miratimit te statusit dhe aktit te themelimit, administratori i shoqerise “Kuka AL” shpk per nje periudhe 5-vjeçare do te jete:

Z. Arion Kuka

Administratori i shoqerise gezon te gjithë te drejtat qe ligji “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare” parashikon pa asnje kufizim te kompetencave. Asambleja e pergjithshme mund te emeroje dhe shkarkoje administratorin ne çdo kohe, me shumice te zakonshme.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Arion Kuka

Handwritten signature of Arion Kuka in blue ink, consisting of the name 'Arion Kuka' and a stylized, circular flourish below it.